

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
"ELITE GROUP" SH.P.K

Sot, më datë 12.09.2021, në Tiranë,

Znj. Evelina Afrim Bach Jensen (Cela), shtetse shqiptare, lindur me datë 18.3.1982, pajisur me pasaporte nr. I25318123C dhe
Z. Saimir Dylber Doku, lindur me datë 06.10.1984, pajisur me pasaporte nr. J41006012V,

Te cilet kane vendosur themelimin e shoqërisë "ELITE GROUP" SH.P.K, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqërinë Tregtare "ELITE GROUP" SH.P.K, Sh.P.K, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar. Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë, ne adresen: Rr. Siri Kodra, kati perdhe, pallati Pegaso Tirane- Shqiperi, zona kadastra 8360, volum 10 faqe 56 dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare perfaqesimi dhe agjenci në Shqipëri edhe jashtë shtetit.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **"ELITE GROUP" SH.P.K,**

NENI 3

Objekti i aktivitetit ekonomik

Shoqëria ka si objekt:

-Ndermjetesim, konsulence, sherbime ne fushen imobiliare, marketing, konsulence ligjore. Perkthime zyrtare, auditim, fiskalizim, vlerësuesime te pasurive.

- Blerje, shitje, shkembimi, menaxhimi dhe administrimi i pasurive te paluajtshme te cdo tipi dhe lloji, punime inxhinierike.

-Shfrytezimi i patentave, aktiviteti i agjencise dhe perfaqesimi e konsulencat teknike ne lidhje me aktivitetet e permendura me siper.

Aktiviteti i formimit:



- Kerkimi, trajnimi dhe ofrimi i personelit, edhe me cilesimin e drejtuesit, si dhe i kuadrove, ne respektim te legjislacionit baze te thirrjes.
- Aktiviteti i projektimit dhe keshillimit
- Gatishmeri, realizim dhe menaxhim i projekteve te cdo lloji, perfshi projektet novatore dhe te kerkim zhvillimit.
- Aktiviteti i agjencise dhe perfaqesimit
- Marrja e porosive te agjencise, me ose pa depozite ne te gjitha sektoret e lartpermendur.

Shoqeria do te mund te zhvilloje te gjitha aktivitetet financiare, te luajtshme, te paluajtshme dhe tregtare qe organi administrativ konsideron te dobishem ose te nevojshem per realizimin e aktiviteve qe perbejne objektin e shoqerise. Mund te marre interesa dhe pjesemarrje ne shoqeri te tjera, ente dhe organizma te cfaredolloji, qe kane qellime te ngjashme ose te lidhura me te sajin, si dhe te leshoje garanci financiare, pengu, dhe te jape garanci pasurore dhe personale edhe per debi te te treteve, gjithmone nese eshte e dobishme ose e nevojshme per realizimin e aktivitetit qe perbejne objektin e shoqerise.

Te gjitha aktivitetet e mesiperme duhet te zhvillohen ne kufijte dhe ne respektim te dispozitave te ligjit ne fuqi dhe ne vecanti perjashtohet aktiviteti kundrejt publikut i cdo lloj aktiviteti te cilesuar nga ligjet ne fuqi si aktiviteti financiar si dhe i cdo aktiviteti tjetër te rezervuar per te rregjistruarit perkates ne dhomat profesionale, listat dhe/ose rregjistrat perkates.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë, ne adresen: Rr. Siri Kodra, kati perdhe, pallati Pegaso Tirane- Shqiperi. Zona Kadastra 8360, Volum 10 Faqe 56.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakeve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 100.000 (njëqindmijë) lek.

Kapitali është i ndarë në:

- Ortaku themelues **Evelina Afrim Bach Jensen** (Cela), zoteruese e nje Kuote me vlere te pergjithshme 50.000 leke qe perben 50 % (pesedhete) te Kapitalit Themeltar te Shoqerise.
- Ortaku themelues **Saimir Dylber Doku**, zoterues i nje Kuote me vlere te pergjithshme 50.000 leke qe perben 50 % (pesedhete) te Kapitalit Themeltar te Shoqerise.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktiviteti fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Aktivitete tregtare mbyllen në datën 31 dhjetor të çdo viti.



NENI 7
Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve;
2. Administratori.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetëm i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërishëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administratori i Shoqërisë i cili pranon do të jetë **Znj. Evelina Afrim Bach Jensen** (Cela), **shtetase shqiptar, i datëlindjes 03.18.1982, lindur ne Sarande dhe banuese ne Tirane.**

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm, edhe jo ortak ose nga shumë administrator, edhe jo ortak, sipas asaj që është përcaktuar në aktin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë i është besuar disa personave, akti i emërimit vendos në alternative që:

- a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegjiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit
- b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 9

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortaket, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 12

Dispozitat përfundimtare



Akt Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua nga Ortaket Themelues te cilet e gjeten atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan pa vërejtje.

ORTAKET THEMELUES
TE SHOQËRISË TREGTARE
"ELITEGROUP" SH.P.K

STATUTI
I SHOQËRISË TREGTARE
"ELITEGROUP" SH.P.K

Sot, më datë 12.09.2021, në Tiranë,

Znj. Evelina Afrim Bach Jensen (Cela), shtetse shqiptare, lindur me datë 18.3.1982, pajisur me pasaporte nr. I25318123C dhe

Z. Saimir Dylber Doku, lindur me datë 06.10.1984, pajisur me pasaporte nr. J41006012V, Te cilet kane vendosur themelimin e shoqërisë "**ELITEGROUP**" **SH.P.K**, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, rregullimin e saj nëpërmjet këtij statuti i cili përban termat e mëposhtëm:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria Tregtare "**ELITEGROUP**" **SH.P.K**, rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare.

NENI 1.
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt:



-Ndermjetesim, konsulence, sherbime ne fushen imobiliare, marketing, konsulence ligjore. Perkttime zyrtare, auditim, fiskalizim, vlerësuesime te pasurive.

- Blerje, shitje, shkembimi, menaxhimi dhe administrimi i pasurive te paluajtshme te cdo tipi dhe lloji, punime inxhinierike.

-Shfrytezimi i patentave, aktiviteti i agjencise dhe perfaqesimi e konsulencat teknike ne lidhje me aktivitetet e permendura me siper.

Aktiviteti i formimit:

- Promovimi, organizimi dhe menaxhimi per llogari te vet, dhe te treteve i mbledhjeve, seminareve dhe kurseve te formimit si ne Shqiperi ashtu dhe jashte shtetit.
- Kerkimi, trajnimi dhe ofrimi i personelit, edhe me cilesimin e drejtuesit, si dhe i kuadrove, ne respektim te legjislacionit baze te thirrjes.
- Aktiviteti i projektimit dhe keshillimit.
- Gatishmeri, realizim dhe menaxhim i projekteve te cdo lloji, perfshi projektet novatore dhe te kerkim zhvillimit.
- Aktiviteti i agjencise dhe perfaqesimit.
- Marrja e porosive te agjencise, me ose pa depozite ne te gjithë sektoret e lartpermendur.

Shoqeria do te mund te zhvilloje te gjithë aktivitetet financiare, te luajtshme, te paluajtshme dhe tregtare qe organi administrativ konsideron te dobishem ose te nevojshem per realizimin e aktiviteteve qe perbejne objektin e shoqerise. Mund te marre interesa dhe pjesemarrje ne shoqeri te tjera, ente dhe organizma te cfaredolloji, qe kane qellime te ngjashme ose te lidhura me te sajn, si dhe te leshoje garanci financiare, pengu, dhe te jape garanci pasurore dhe personale edhe per debi te te treteve, gjithmone nese eshte e dobishme ose e nevojshme per realizimin e aktivitetit qe perbejne objektin e shoqerise.

Te gjitha aktivitetet e mesiperme duhet te zhvillohen ne kufijte dhe ne respektim te dispozitave te ligjit ne fuqi dhe ne vecanti perjashtohet aktiviteti kundrejt publikut i cdo lloj aktiviteti te cilesuar nga ligjet ne fuqi si aktiviteti financiar si dhe i cdo aktiviteti tjetër te rezervuar per te rregjistruarit perkates ne dhomat profesionale, listat dhe/ose rregjistrat perkates.

NENI 2.

Emri dhe selia e Shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do te paraqitet në qarkullim me emërtimin e saj **"ELITEGROUP" SH.P.K.**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresën: Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë, ne adresen: Rr. Siri Kodra, kati perdhe, pallati Pegaso Tirane- Shqiperi.

NENI 3.

Regjimi Juridik i Shoqërisë.

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit. Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit së Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi. Me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme, Shoqëria

mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE.

NENI 4.

Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë përveç për pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre që duhet të derdhen në kapitalin fillestar.

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Ortakëve. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qera, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Asamblese se Ortakeve.

NENI 5.

Të drejtat e ortakëve.

Ortakët kanë të drejtë të administrojnë aktivitetin e shoqërisë konform objektit të saj përfshirë këtu aktivitetin produktiv dhe tragar që mund të ushtrojë, të drejtat intelektuale dhe ekonomiko-finaciare.

Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruar deri në atë moment.

Ortakët konform Aktit të themelimit dhe statutit kanë të drejtë të jenë në të njëjtën kohë ortak edhe te shoqërive të tjera.

NENI 6.

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria ka një kohëzgjatje të pacaktuar . Asambleja e ortakeve mund të vendos një kohëzgjatje me anë të një vendimi të marrë konform me statutin dhe ligjin.

III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË.

NENI 7.

Veprimtaria e funksionimit të Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

NENI 8.



Kapitali fillestar i investuar nga Ortakët, përbën bazën e krijimit të fondit themeltar të mjeteve të xhiros. Administratori i dorëzon Ortakëve dokumentin vërtetues për sasinë e shumave të derdhura në fazën e themelimit.

NENI 9. Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakeve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 100.000 (njëqindmijë) lek.

Kapitali është i ndarë në:

- Ortaku themelues **Evelina Afrim Bach Jensen** (Cela), zoteruese e nje Kuote me vlere te përgjithshme 50.000 leke qe perben 50 % (pesedhete) te Kapitalit Themeltar te Shoqerise.
- Ortaku themelues **Saimir Dylber Doku**, zoterues i nje Kuote me vlere te përgjithshme 50.000 leke qe perben 50 % (pesedhete) te Kapitalit Themeltar te Shoqerise.

NENI 10. Pasuria e Shoqërisë

Shoqëria bëhet pronare e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme kur vlera e pasurisë mbulohet tërësisht në të holla. Shoqëria nuk ka detyrimin e nuk përgjigjet për kthimin e kompensimin e tokës së blere nga shteti tek ish-pronarët.

NENI 11. Pronësia mbi kuotat.

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shit-blerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

NENI 12. Miratimi i Asamblesë së Përgjithshme për fitimin apo kalimin e kuotave.

Pavarësisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave, është i nevojshëm miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen sipas ligjit, ndryshe janë të pavlefshme.

NENI 13. Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit



Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme e ortakeve.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme e ortakeve, vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

NENI 14. Fondet rezerve

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike.

Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerien e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

NENI 15. Përdorimi i të ardhurave neto.

E ardhura neto që rezultojnë mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kredinë për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortakët, sipas qëllimeve të tyre.

NENI 16. Bilanci, plani financiar.

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

NENI 17. Shpërndarja e fitimeve

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

IV. ORGANET E SHOQËRISË.

NENI 18.



Asambleja e Përgjithshme

Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të cilat kërkojnë $\frac{3}{4}$ e votave në rastet e mëposhtme:

1. ndryshimet e statutit;
2. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
3. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
4. shpërndarjen e fitimeve;
5. raste të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti;

për rastet e tjera ajo vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës si më poshtë:

1. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 2. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
 3. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 4. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 5. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 6. përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar.
 7. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 8. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 9. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

NENI 19.

Asambleja e Përgjithshme është e detyruar dhe me çdo kusht të mblidhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë në rastet e mëposhtme: sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Në rastet e parashikuara në pikën një dhe tre më sipër, përpara Asamblesë së Përgjithshme paraqitet një raport i përgatitur nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

Në raste e parashikuara në pikën një dhe tre Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

NENI 20.

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 21.

Kuorumi i nevojshëm dhe vendim-marrja

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

NENI 22.

Procesverbali i mbledhjes se asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

NENI 23.

Hetimet e posaçme

Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.



Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit në të kundërt brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.

E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

Në rastet e vendimeve të parregullta të administratorit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë ti kërkojë Gjykatës kompetente shfuqizimin e këtyre vendimeve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit apo statutit.

Ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme apo secili kreditor i shoqërisë mund ti kërkojë asamblesë së Përgjithshme shfuqizimin si më sipër, ose ata mund të procedojnë vetë përpara gjykatës brenda 30 ditëve nga refuzimi i asamblesë për ngritjen e padisë. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.

Procedurat përpara gjykatës ndiqen nga një përfaqësues i posaçëm i shoqërisë i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Kreditorët apo ortakët e sipërpërmendur kanë të drejtë të kërkojnë përpara gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit kur ka dyshime në lidhje me të për përfaqësimin e tij jo në interes të shoqërisë.

Rastet e hetimeve të posaçme dhe shfuqizimit të vendimeve të parregullta do të rregullohen sipas neneve 91 dhe 92 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 24.

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratori i Shoqërisë "ELITEGROUP" Sh.p.k, do të jetë **Znj. Evelina Bach Jensen (Cela)**, e emeruar ne detyren e Administratorit per nje afat kohor 5- vjeçar .

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 25.

Të drejtat dhe detyrimet e administratorit



Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

1. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asamblëja e përgjithshme;
2. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
3. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblësë së përgjithshme për miratim;
5. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
7. raportojë përpara asamblësë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
9. të thërrasë asamblënë e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Në rast se Asamblëja e Përgjithshme cakton më shumë se një Administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asamblëja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

Asamblëja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 26.

Shpërblimi i administratorëve

Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblësë së përgjithshme.

Shpërblimi, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asamblëja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 27

Eksperti kontabël

Shoqëria cakton ekspertin kontabël për çdo vit financiar kur jemi përpara rasteve të parashikuara nga ligji. Emërimi i tyre bëhet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Ekspertët kontabël janë përgjegjës për mbajtjen e dokumentacionit të shoqërisë në mënyrë të rregullt.

Nuk mund të marrin detyrën e ekspertit, administratorët apo ortakët, si dhe personat me lidhje gjaku deri në shkallë të katërt.

VI. MARRDHËNIET E PUNËS.

NENI 28.

Marrdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontratës individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve. Marrdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

NENI 29.

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

VI. PRISHJA E SHOQËRISË. LIKUJDIMI.

NENI 30.

Kjo Shoqëri do të priset në rast kur:

1. merr vendim Asambleja e Përgjithshme;
2. hapen procedurat e falimentimit;
3. nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
4. merret një vendim gjykate;
5. për arsye të tjera, të parashikuara në statut;

Prishja e shoqërisë rregjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga Administratorët.

NENI 31.

Likuidimi i shoqërisë

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.



Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare priset me vendim gjykate.

Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata rregjistrohet *ex officio*, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i rregjistruar i shoqërisë ndiqet nga shënimi "në likuidim". Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj brenda 30 ditëve. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

NENI 32.

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e preferimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 110/2016 "Per falimentimin".

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

NENI 33.

Bilancet

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 34.

Shpërndarja e aktiveve

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve apo aksionarëve. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura,

likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon ç'rregjistrimin e shoqërisë.

NENI 35.

Likuidimi i thjeshtëzuar

Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet një procedurë të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.

Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.

Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përveç administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT.

NENI 36.

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe rregjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 37.

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 38.

Ky Statut përpilohet në tre (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE "ELITEGROUP" SHPK

Erdina Badri Jexeni
(CSCA)

Saimir Dylber Doku